

Regjistrimet në kopshtet komunale për vitin shkollor 2021/2022 **Si kryhet regjistrimi on-line**

Për të kryer regjistrimin on-line (shërbimi është aktiv nga ora 8.00 e datës 4 janar 2021 deri në orën 20 të datës 25 janar 2021) është e nevojshme që të keni **një** nga dokumentet e mëposhtëme:

1. Sistemin Publik për menaxhimin e Identitetit Dixhital (SPID)

<http://servizi.comune.fi.it/servizi/servizi-spid>

2. Librezën shëndetësore të rajonit të aktivizuar në sportelet e ASL-it të Qarkut të Toskanës (Regione Toscana).

Për informacione <http://www.regione.toscana.it/servizi-online/servizi-sicuri/carta-sanitaria-elettronica>

3. Kartën Nazionale të Shërbimeve (CNS) *

<http://www.regione.toscana.it/-/carta-nazionale-dei-servizi>

* Për disponuesit e Librezës Shëndetsore Rajonale dhe Kartës Nazionale të Shërbimeve të aktivizuar është e nevojshme të dispononi lexuesin smart card i cili mund të blehet në Qëndrat Shëndetsore (ASL), dhe është e mundur të hyni në Shërbimin Online **vetëm** nga pc juaj.

4. Kredencialet e identifikimit (emërin e përdoruesit dhe fjalë kalimin): kush nuk i ka mund t'i kërkojë personalisht (i pajisur me një dokument identifikimi të vlefshëm dhe kodin fiskal) duke fiksuar një takim pranë:

- sporteleve të **Zyrave për Mardhënieniet me Publikun (URP)** të Komunës së Firences <http://servizi.comune.fi.it/servizi/scheda-servizio/sportelli-al-cittadino-urp>
- ose pranë **Zyrës së Informacionit të Shërbimit për fëmijrinë**, Rruga Nicolodi n. 2 (**dhoma A66 kati dytë** Drejtoria Arsimore /Direzione Istruzione);
- ose, nëse je një qytetar i huaj pranë **Sportelit për Emigrimin**, Villa Pallini, Rruga Baracca n.150 P;
http://politichesocioabitative.comune.fi.it/stranieri/servizi/sportelli_immigrazione.html

Nuk mund ti lëshohen kredencialet personave të tretë të autorizuar.

Gjatë hyrjes së parë, kredencialet duhen të aktivizohen duke dërguar e-mailin e duhur të konfirmimit.

Ju informojmë që nuk do jetë më e mundur lëshimi i kredencialeve nga data 28 shkurt 202

Pasi të dispononi një nga këto instrumente (SPID ose CNS ose librezën shëndetsore të aktivizuar ose kredencialet e hyrjes) mund të përdorni shërbimin on-line i cili i është dedikuar regjistrimit në kopshte me anë të linkunt të mëposhtëm

<http://servizi.055055.it/iscrizionematernefe/>

Shërbimi do të jetë aktiv nga ora 8:00 e datës 4 janar 2021 deri në orën 20:00 të datës 25 janar 2021

Familjet e huaja të cilat janë rezidente në Firenze dhe kanë vështirsi në kuptimin e gjuhës italiane ose që sidoqoftë kanë nevojë për mbështetje dhe për konsultim, mund ti drejtohen **Sportelit të Emigrimit** Lagjia 5 Villa Pallini, Rruga Baracca 150 P, ku do të gjejnë asistencën e nevojshme për plotësimin e modularit të regjistrimit on line dhe në praninë e mundshme të ndërmjetësit të gjuhës dhe kulturës përkatëse.

Për të lënë **një takim** duhet të kontaktoni direkt **Sportelin e Emigrimit** në numrin 055 2767078 ose të dërgoni një e-mail në adresën immigr@comune.fi.it

Mund të telefononi edhe për informacione të përgjithshme.

http://politichesocioabitative.comune.fi.it/stranieri/servizi/sportelli_immigrazione.html

Kërkesa e regjistrimit paraqitet në formën e vetëdeklarimit dhe deklarimit të aktit noterial, sipas D.P.R nr. 445/2000 dhe modifikimet e plotësimet pasuese, me përjashtim të disa situatave për të cilat do të kërkohet dokumentacioni specifik.